PRIMUS
A L B A N I A

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK
Nr. 772 Prot.
Datë,më 11.04.2023

Head Office:
Rruga Margarita Tutulani,
Pallati Viridario 1 - Tirana
T | +355 (0)69 707 3123
E | info@primus.com.al

Shtojca 20

# FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

## Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

**Primus Albania sh.p.k. / NUIS L42202028V**
Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

**Rr. "Margarita Tutulani", Pallati Viridario 1**
Adresa

| | | |
|---|---|---|
| **Tiranë** | **Shqipëri** | **1001** |
| Qyteti | Shteti | Kodi Postar / Posta |

| | |
|---|---|
| **+355 697073123** | **N/A** |
| Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës) | Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës) |

**info@primus.com.al**
E-mail

**Denisa Sala – Drejtore Ekzekutive** Denisa Sala
Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

NUIS: L42202028V Primus Albania Sh.p.k TIRANA - ALBANIA

| | |
|---|---|
| | **07.04.2023** |
| Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar | Data (viti/muaji/dita) |
| **+355 697073123** | |
| Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës) | Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës) |

## Seksioni II. Informacion mbi procedurën

1. **Numri i referencës së procedurës/Lotit**

**REF-64461-03-31-2023**

2. **Lloji i Procedurës**

| | |
|---|---|
| Procedurë e hapur ☐ | Procedurë e hapur e thjeshtuar X |
| Procedurë e kufizuar | Procedurë konkurruese me negocim |

| | |
|---|---|
| ☐ | ☐ |
| Partneritet për inovacion ☐ | Dialog konkurrues ☐ |
| Procedurë me negocim me shpallje paraprake të njoftimit ☐ | Procedurë me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës ☐ |
| Shërbim Konsulence ☐ | |
| Kontratë e lidhur pa zhvilluar ndonjë nga procedurat e prokurimit të parashikuara në LPP ☐ | |

3. Autoriteti /Enti Kontraktor
**Ujësjellës Kanalizime Sh. A. Shkodër**

4. Vlera e përllogaritur e prokurimit
**1,500,000 Lek**

5. Objekti i kontratës/Marreveshjes Kuadër
**"Ristrukturim dhe megrim i DB te sistemit te faturimit Al Billing si dhe ngritjen e Proxy dhe AD"**

6. Afati i fundit për paraqitjen e ofertës
**13.04.2023**

7. Data e publikimit te Njoftimit te Fituesit
**Nuk aplikohet**

8. **Data e nënshkrimit të kontratës**

*(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës)*
**Nuk aplikohet**

**Seksioni III. Përshkrimi i ankesës**

1.Baza ligjore (Shkelje ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)
**Ligji nr. 162/2020, Për Prokurimin Publik**
**Dokumentat Standarde të Tenderit**

Head Office:
Rruga Margarita Tutulani,
Pallati Viridario 1 - Tirana
T | +355 (0)69 707 3123
E | info@primus.com.al

**2. Objekti i ankesës**

- Modifikim i dokumentave të tenderit

X

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

☐

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ve ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

☐

*(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)*

- Pavlefshmëri kontrate

☐

*(Citoni kontratën për të cilën kërkoni pavlefshmërinë)*

- Tjetër

☐

*(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)*

**3. Rrethanat dhe faktet**

Në datë 03.04.2023 në SEP të APP identifkuam publikimin e procedurë së prokurimit nr. REF-64461-03-31-2023 me objekt prokurimi "Ristrukturim dhe megrim i DB te sistemit te faturimit Al Billing si dhe ngritjen e Proxy dhe AD", me fond limit 1,500,000 lek publikuar nga Ujësjellës Kanalizime Sh. A. Shkodër. Afati i dorëzimit të ofertave është data 13.04.2023, ora 10:00, njoftimi si më poshtë:

Ristrukturim dhe megrim I DB te sistemit te faturimit Al Billing si dhe ngritjen e Proxy d...

Profili/Periudha | Formularët e Vlerësimit | Dokumentet e Tenderit | Njoftimet e Kontratës | Kërkesat

**Objekti i Procedurës**

Ristrukturim dhe megrim I DB te sistemit te faturimit Al Billing si dhe ngritjen e Proxy dhe AD

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Procedurat** | E hapur, e thjeshtuar | **Tipi i Kontratës** | Shërbime |
| **Njoftimi Përfshin** | Kontratë Publike | **Numri** | REF-64461-03-31-2023 |
| **Data e Hapjes se Tenderit** | 3.4.2023 09:00 | **Afati i Fundit per Pranimin e Ofertave** | 13.4.2023 10:00 |
| **Vlera e Përllogaritur** | 1.500.000,00 | **Autoriteti Kontraktues** | Sh.A Ujesjelles Kanalizime Shkoder |
| **Kodi CPV** | 72200000-7 | | |
| **Kohëzgjatja** | 1 muaj | | |
| **Marrëveshja Kuader** | | | |

Duke identifikuar parregullsi në dokumentet e tenderit, konkretisht në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit po kërkojmë rishikimin/ndryshimin e tyre.

Në shtojcën 8. Formular i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit, Kap. 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 2.3.3, është kërkuar:

Head Office:
Rruga Margarita Tutulani,
Pallati Viridario 1 - Tirana
T | +355 (0)69 707 3123
E | info@primus.com.al

*2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i autorizuar nga autorët e programit kompjuterik "Al-Billing", sistemi i faturimit në përdorim dhe rregjistruar pranë ZSHDA me Nr. 57 RDA per kategorinë e veprës "Programe Kompjuterike", Neni 7/A, ose ekuivalente. Gjithashtu mund të paraqesin Autorizim të lëshuar nga autorët e programit kompjuterik, që kanë të drejtën të ofrojnë shërbimin për "Programin kompjuterik AL Billing" jo më heret se 3 vjet.*

Ne vlerësojmë se kërkesa "... *Autorizim të lëshuar ... jo më herët se 3 vjet*", është e pambështetur në ligj dhe e pakuptimtë.

**4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara**

Vendosja në formulimin e kriterit si kriter vlefshmërie e një afati kohor për autorizimin e lëshuar nga autori i programit kompjuterik, në rastin konkret "... *jo më herët se 3 vjet*" është në kundërshtim me përcaktimet ligjore, konkretisht ligji nr. 9380, datë 28.04.2005 "Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të" i shfuqizuar (citohet ky ligj pasi ka lidhje me kohën e lëshimit të autorizimit) dhe aktual Ligji nr. 35, dt. 31.3.2016 "Per te drejten e autorit dhe te drejtat e tjera te lidhura me te".

1. Marrëdhënia Autor dhe i Autorizuar nga Autori është një marrëdhënie juridike tregtare ndërmjet dy subjekteve, e cila rregullohet me kodin civil dhe legjislacionin në fuqi të sipërcituar dhe nuk mundet një subjekt i tretë të ndërhyjë dhe vendosë normativa jashtë kuadrit ligjor në fuqi në marrëdhënien e tyre (Autor dhe i Autorizuar), për më shumë mbi akte të prodhuara në kohë, që janë ende në fuqi dhe nuk kanë qënë në kundërshtim me ligjin.
2. Autorizimi lëshohet nga Autori për përfaqësim në një procedurë konkrete prokurimi, por mundet që Autori mbështetur në legjislacionin në fuqi dhe me vullnet të tij, për një produkt konkret të kalojë të drejtat pasurore në formën ekskluzive për një periudhë kohore të papërcaktuar, sipas përcaktimeve ligjore në kohën e lëshimit të tyre.
3. Si Ligji nr. 9380, datë 28.04.2005 "Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të" i shfuqizuar ashtu edhe Ligji nr. 35, dt. 31.3.2016 "Per te drejten e autorit dhe te drejtat e tjera te lidhura me te" aktualisht në fuqi, në rastin e programeve kompjuterike, nuk përcaktojnë afate kohore të vlefshmërisë të autorizimit apo kalimit të së drejtës pasurore ekskluzive nga Autori tek i Autorizuari. Pra, afatet kohore të vlefshmërisë të autorizimit përcaktohen nga vetë subjektet Autor dhe i Autorizuari dhe shprehen në aktin e firmosur nga palët.

Pra, siç theksuam më lart, marrëdhëniet ndërmjet subjekteve private në rastin e kalimit të të drejtave pasurore për programet kompjuterike përcaktohen e rregullohen me akte ligjore, konkretisht ligjet e sipërcituara dhe nuk mundet asnjë autoritet/ent/subjekt, në kundërshtim me këto ligje të përcaktojë/ vendosë afate të tjera vlefshmërie të kalimit të të drejtës pasurore për programet kompjuterike nga ato që vetë subjektet e interesuara dhe vetë autorizimi përcakton.

Ndërkohë në rastin e programeve kompjuterike ligjet e sipërcituara nuk kanë parashikuar afate kohore për vlefshmërinë e kalimit të të drejtës pasurore.

**Për këtë arsye kërkojmë që përcaktimi afatit kohor të lëshimit të autorizimit, citojmë "... *jo më herët se 3 vjet*" i vendosur nga Autoriteti Kontraktor në kundërshtim me ligjin, të hiqet nga paragrafi 2.3.3.**

PRIMUS
A L B A N I A

Head Office:
Rruga Margarita Tutulani,
Pallati Viridario 1 - Tirana
T | +355 (0)69 707 3123
E | info@primus.com.al

**5. Kërkesë për ekspertizë të posacme**

| Po | Jo |
| --- | --- |
| ☐ | X |

*(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkoni)*

______________________________________________

**6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:**

**Nuk aplikohet**

7. **Lista e informacionit konfidencial:**

**Nuk aplikohet**

*Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.*

***Kujdes: Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik***

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit te Prokurimit Publik.**

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/ entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

**Denisa SALA**
**Drejtore Ekzekutive**

DSala

NUIS: L42202028V • Primus Albania Sh.p.k • TIRANA - ALBANIA

**E-mail: info@primus.com.al**